

VENDIM
Nr. 530, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 568, DATË 6.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT, ORËT SHITESË DHE KOMPENSIMIN E TYRE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETËTËRORE, INSTITUCIONET E PAVARURA DHE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 40, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të neneve 76, 78, 79, 83, 85, 86, 87, 94, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kohëzgjatja ditore e orëve të punës për të punësuarit në institucionet e administratës shtetërore, nga e hëna në të enjte, është 8 orë e 30 minuta, ndërsa ditën e premte është 6 orë. Për këto institucione:

a) aplikohet orari ditor fleksibël, me kushtin që brenda ditës të plotësohen orët e plota të punës, sipas përcaktimit në këtë pikë;

b) orari i detyrueshëm, kur të gjithë të punësuarit duhet të jenë në vendet e punës, nga e hëna në të enjte, është 9:30 – 15:30, ndërsa ditën e premte 9:30 – 13:00.”.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Orari ditor i punës për të punësuarit në institucionet e pavarura dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit.”.

2. Në kreun III bëhen këto shtesa:

a) Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm ka të drejtë ta delegojë kompetencën e përcaktimit të kohës së kryerjes së pushimit vjetor të paguar te drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.”;

b) Në fund të pikës 15 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm ka të drejtë ta delegojë kompetencën e përcaktimit të kohëzgjatjes së pushimit pa të drejtë page te drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama